REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI-CORRUPTION AGENCY
Dep. DPK
Nr. Prot. 03-02/3642/17
Nr. i faq. 02
Data 03.11.2017
PRISHTINË

# Republika e Kosovës

## Republika Kosova - Republic of Kosovo

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT**
**AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE**
**ANTI – CORRUPTION AGENCY**

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 03.11.2017, mori:

## V E N D I M

**I.** ***Mbyllet rasti me nr. AKK–03-02-2392/17, për zyrtaren e lartë znj.Majlinda Gjelaj, Prodekane për çështje mësimore në Fakultetin e Edukimit ne Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtin" për shkak se zyrtarja e lartë ka shmangur gjendjen e mundshme të konfliktit të Interesit dhe papajtueshmërisë në ushtrim të funksionit publik .***

**II.** Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

## A r s y e t i m

**I.** Rasti i shqyrtuar për konflikt të interesit me numër protokolli AKK–03-02-2392/17,qe për trajtim ka pasur zyrtaren e lartë znj.Majlinda Gjelaj, Prodekane për çështje mësimore në Fakultetin e Edukimit ne Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina".

Gjatë zhvillimit të procedurës për identifikimin e rasteve të konfliktit të interesit, është vërejtur se zyrtarja e lartë znj.Majlinda Gjelaj, figuron si person i autorizuar në një biznese private e që sipas Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik Nr.04/L-051, kjo situatë paraqet konflikt të interesit, dhe mos pajtueshmëri në ushtrimin e funksionit publik, andaj Agjencia kundër Korrupsionit e ka njoftuar zyrtaren e lartë me shkresën e parë se ka filluar procedura e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të Konfliktit të Interesit dhe se ka të drejtë në afatin prej 15 ditësh të njoftohet me faktet qe posedon Agjencia.

Pas kësaj shkrese znj,Gjelaj, ka ardhur në takim ne zyrat e AKK-së dhe nga zyrtarët e AKK-së, është njoftuar me faktet qe posedon Agjencia lidhur me rastin e iniciuar për te.

znj. Majlinda Gjelaj, është pajtuar me gjendjen, por është arsyetuar se nuk ka qen i informuar se kjo situatë është ne kundërshtim me ligjin në fuqi dhe ka deklaruar se biznesi ne fjalë nuk zhvillon aktivitet, por është zotuar se brenda afatit ligjor do të bej ndryshimet dhe do të veproj sipas ligjit në fuqi për ta parandaluar situatën e mundshme të konfliktit të interesit.

Pas kësaj shkrese nga znj.Majlinda Gjelaj, Prodekane për çështje mësimore në Fakultetin e Edukimit ne Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina" kemi pranuar një dokument të lëshuar nga ARBK-ja, ku shihet se znj.Gjelaj, nuk figuron me si person i autorizuar në biznesin me emër N.SH "GJENIU I VOGEL" .

Vlerësojmë se pas veprimeve të ndërmarra nga znj.Majlinda Gjelaj, Prodekane për çështje mësimore në Fakultetin e Edukimit në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina" duke u larguar nga funksioni si person i autorizuar ne biznesin privatë janë krijuar rrethana të reja dhe është shmangur gjendjen e mundshme e konfliktit të interesit dhe papajtueshmërisë në ushtrimin e funksionit publik për zyrtaren e lartë, dhe u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**II.** Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja,

Shaip Havolli
Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)